



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
KORÇË

Nr. 26. Prot.

Korçë, më 24.02.2014
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

Lënda: Dërgohet marrëveshje bashkëpunimi.

Drejtuar: Universitetit "Kadri Zeka", Gjilan
KOSOVË

Bashkëngjitur po ju përcjellim katër kopje origjinale të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Universitetit "Kadri Zeka" të Gjilanit, Kosovë dhe Universitetit "Fan S. Noli" të Korçës, Shqipëri, të cilat duhet të vulosen nga ana juaj dhe vetëm dy kopje të marrëveshjes të dërgohen pranë Universitetit tonë me rrugë postare.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Prof.as.dr. GJERGJI MERO

REKTOR





MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
MIDIS UNIVERSITETIT "KADRI ZEKA" TË GJILANIT, KOSOVË
DHE
UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI" TË KORÇËS, SHQIPËRI

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi bëhet ndërmjet Universitetit "Kadri Zeka" të Gjilanit, të përfaqësuar nga Rektori, **Prof.as.dr. ARBEN DERMAKU** dhe Universitetit "Fan S. Noli" të Korçës të përfaqësuar nga Rektori, **Prof.as.dr. GJERGJI MERO**.

NENI 1

Kjo marrëveshje synon të lehtësojë dhe të promovojë shkëmbimet kulturore dhe edukative midis Universitetit "Kadri Zeka" të Gjilanit dhe Universitetit "Fan S. Noli" të Korçës, Shqipëri, në fushat e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor për çështje të përbashkëta, si edhe të promovojë veçanërisht zhvillimin e programeve të përbashkëta në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

NENI 2

Aktualisht, marreveshja do të përfshijë fushat e studimit që mbulohen nga Fakultetet e Edukimit dhe Ekonomisë në të dy Universitetet:

- 1- Mësimdhënie
- 2- Administrim biznesi
- 3- Financë
- 4- Marketing

Mund të shtohen dhe disiplina të tjera me marrëveshje dypalëshe midis palëve kontraktuese. Për secilin Universitet do të ngarkohet një person, i cili do të monitorojë zhvillimin e programeve të përbashkëta.

NENI 3

Palët kontraktuese sipërmarrin rregullisht të shkëmbejnë informacione në lidhje me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fushat përkatëse, si edhe të shkëmbejnë përvoja duke lehtësuar botimin e artikujve shkencorë në buletinet respektive të të dy universiteteve dhe të promovojnë seminare dhe takime duke i kushtuar një vëmendje të veçantë zbatimit të projekteve të përbashkëta të kërkimit në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të procesit të ndërkombëtarizimit të mësimdhënies dhe të programeve të trajnimit.

Në kuadër të kornizës së përgjithshme që shprehet më sipër, të dyja palët kanë rënë dakord për të mbështetur bashkëpunimin dhe për të marrë masat e nevojshme siç shpjegohet më poshtë.

1. Të dyja palët do të përfitojnë nga njohuritë dhe përvojat e njëri-tjetrit për të gjetur zgjidhje për problemet shkencore në fushat e interesit të tyre.
2. Të dyja palët do të shkëmbejnë stafin akademik për të përfituar nga përvojat dhe mendimet e njëri-tjetrit.
3. Të dyja palët do të mbështesin stafin kërkimor dhe shkëmbimin e ndërsjellë të studentëve në fushat me interes të përbashkët.



4. Palët do të shkëmbejnë reciprokisht libra, botime të tjera të ndryshme dhe materialet që do të përdoren për arsim, trajnim dhe qëllime kërkimore.
5. Të dyja palët reciprokisht do të nxisin organizimin e takimeve shkencore.
6. Të dyja palët do të mbështesin punimet kërkimore në fushat me interes të përbashkët.

NENI 4

Duke pasur parasysh mjetet financiare që ka në dispozicion çdo universitet, dhe mbi bazën e programeve të ndryshme që mund të ndërmerren gjatë gjithë periudhës së bashkëpunimit, palët kanë rënë dakord që të shkëmbejnë staf pedagogësh, kërkues shkencorë, studentë dhe anëtarë të stafit teknik në përbashkjet e kësaj marrëveshjeje.

NENI 5

Mjetet financiare me të cilat do të vihet në zbatim kjo marrëveshje, për të dy palët kontraktuese do të realizohen nëpërmjet vetë institucioneve dhe institucioneve të ngjashme private dhe publike me protokolle të veçanta.

Brenda kushteve të përcaktuara në rregulloren e çdo universiteti, palët kontraktuese do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të kërkuar burime financiare me qëllim që të plotësohen tërësisht ose pjesërisht shpenzimet e duhura për të mundësuar këtë marrëveshjeje.

NENI 6

Kostot e shëndetit dhe të siguracionit, në rast të ndonjë sëmundjeje ose aksidenti, do të mbeten përgjegjësi e secilit person në vetvete.

NENI 7

Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë tre vjeçare dhe do të skadojë me 21.02.2014 Secila nga palët kontraktuese mund të kërkojë tërheqjen nga kjo marrëveshje në çdo kohë duke bërë një njoftim me shkrim para gjashtë muajsh.

Nëse asnjë nga palët nuk do ta bënte një gjë të tillë, marrëveshja do të konsiderohet e rinovuar për një periudhë të mëtejshme tre-vjeçare.

Marrëveshja do të hyjë në fuqi pasi të jetë firmosur nga Rektorët e të dy Universiteteve. Ajo është përgatitur në dy kopje, në gjuhën shqipe, dhe secila nga palët do të mbajë nga një kopje të Marrëveshjes.

UNIVERSITETI
"KADRI ZEKA", GJILAN

Rektori

Prof. Dr. KADRI ZEKA
Prof. Dr. BURZEN DERMAKU



Date: 21.02.2014

UNIVERSITETI
"FAN S. NOLI", KORÇË

Rektori

Prof. as. dr. GJERGJI MERO

